

PLANI I BIZNESIT

për kultivimin dhe grumbullimin e BMA-ve (bimëve medicinale dhe aromatike) nga komunitetet brenda dhe rreth KKPA-së (Parkut Kombëtar Korab-Koritnik).

MAJ 2023

Ky raport është publikuar nga organizata World Vision Albania në kuadër të projektit “Përmirësimi i jetesës përmes ruajtjes së biodiversitetit të parkut natyror Korab Koritnik”, financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust – PONT.

Raporti është hartuar nga:

- Prof. Dr. Alban Ibraliu
- Dr. Zyber Gjoni

Grupi teknik mbështetës:

- Majlinda Hoxha, Këshilltare Teknike, World Vision Albania
- Erblin Burnazi, Manaxher Projekti, World Vision Albania

Raporti mund të përdoret lirisht nga grupet e interesit.

Në çdo rast, shumëfishimi ose ripublikimi i këtij raporti duhet të shoqërohet me autorizimin e World Vision Albania dhe PONT.

PËRMBAJTJA

1. KONTEKSTI.....	5
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
3. ARSYET PSE ËSHTË E NEVOJSHME NDËRHYRJA	10
4. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE SHTRIRJA NË KOHË E TIJ	11
5.KULTURAT/BIMET E IDENTIFIKUARA	12
5.1 KARAKTERISTIKAT PËR ÇDO KULTURË	13
Rigoni.....	13
Ciani.....	14
Mëllaga.....	16
Kalendula	18
Agulice.....	20
5.2 ZONAT E IDENTIFIKUARA.....	20
6. MODELI I PROPOZUAR PER KULTIVIM (DO ZHVILLOHET PER CDO KULTURE ME VETE - SO SHERBEJE DHE SI MATERIAL TRAJNIMI)	22
6.1 MODELI I FERMES	22
6.2 MODELI FINANCIAR - MODEL I THJESHTE SHPENZIME – SHITJE	23
6.3 ZINXHIRI I VLERES - FURNITOR -> PIKE GRUMBULLIMI.....	25
6.4 KULTIVIMI DHE CIKLET E TIJ.....	25
7. MODELI I IDENTIFIKIMIT TE GRUPIT	26
7.1 KARAKTERISTIKAT E GRUPIT	26
7.2 MOSHA, GJINIA, ZONA, BIMËT E MUNDSHME PËR TË MBLEDHUR	26
7.3 NDARJA E GRUPIT.....	26
7.4 MODELET E PROPOZIMIT TË QASJES	27
7.5 ZBATIMI	27
8. ZHVILLIMI I TAKIMEVE DHE TRAJNIMEVE ME INDIVIDET.....	28
8.1 MODELI I TRAJNIMIT.....	28
8.2 KOHËZGJATJA	28
8.3 FREKUENCA	29
8.4 TAKIME ME AKTORË TË ZINXHIRIT TË VLERAVE:	29
9. MODELI I NDJEKJES NË VAZHDIMËSI TË INDIVIDËVE POTENCIALE.....	29
9.1 NË FAZAT E MBJELLJES:.....	30
9.2 GJATË KULTIVIMIT:	30
9.3 GJATË VJELJES	31
9.4 MARRËDHËNIET TREGTARE OSE TREGTARE ME PALËT E TRETA:.....	31
9.5 OFRIMI I NDIHMËS NË NDJEKJEN E VAZHDUESHME TË PROCESIT:	31

**10. DISA TREGUES KYÇ TË PERFORMANCËS (KPI) NË MOMENTIN QË DO TË MATET SUKSESI
DHE EFEKTIVITETI I PROJEKTIT MUND TË JENË: 33**

1. Konteksti

Në studimin e mëparshëm të kryer nga FSRD me mbështetjen e World Vision Albania, *“Vlerësimi i situatës dhe potencialeve të bimëve mjekësore dhe aromatike, në zonën e mbrojtur Korab-Koritnik”* janë evidentuar disa probleme që lidhen me vjeljen e pakontrolluar të bimëve aromatike dhe mjekësore të florës spontane nga banorët e kësaj zone. Për rrjedhojë ka një presion të lartë për reduktimin e popullatave të disa BMA-ve, veçanërisht për ato bimë që janë të klasifikuara në një nga statutet e rrezikimit.

Në këtë situatë është e rëndësishme që banorëve të kësaj zone dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në sektorin e BMA-ve t’u ofrohen modele të zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve bimore dhe tokës së kultivuar pranë parkut kombëtar Korab – Koritnik dhe zonave rreth saj. Puna për ndërgjegjësimin e vjelësve dhe kompanive të eksportit për ruajtjen e biodiversitetit nuk është e mjaftueshme për të arritur rezultate të kënaqshme në plan afatgjatë.

Ndërhyrja më efikase për të zbutur trysninë e shfrytëzimit të pakontrolluar të bimëve spontane të kësaj zone, vlerësohet të jetë nxitja e kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore në këtë zonë. Një shembull i mirë suksesi për t’u përmendur është kultivimi i BMA-ve më zonën e Malësisë së Madhe, ku sot janë të mbjella rreth 10 ha me bimë aromatike dhe mjekësore, kryesisht sherebele dhe helychrisum. Deri më sot, në zonën e Dibrës është punuar pak në këtë fushë.

Për rrjedhojë lind nevoja që World Vision Albania në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat dhe publik të zhvillojnë dhe të promovojnë modelet e duhura për të nxitur fermerët e zonës së parkut kombëtar Korab Koritnik dhe zonave përreth saj të kultivojnë, përpunojnë dhe shesin bimë aromatike dhe mjekësore.

FSRD pasi ka kryer një vlerësim të kushteve agro – klimaterike të kësaj zonë paralelisht me një studim të tregut, ka identifikuar 5 bimë aromatike dhe mjekësore me interes të veçantë për kultivimin e tyre: rigoni, ciani, mëllaga, kalendula dhe aguliçja. Gjithashtu, si zona të përshtatshme për kultivimin e këtyre bimëve janë njësitë administrative pranë parkut kombëtar Korab – Koritnik, Maqëllarë, Melan, Muhurr, Sllovë, Kastriot.

Në këtë plan biznes do të paraqitet një analizë e përfitimeve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore që sjell përfshirja e fermerëve të zonës në kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore. Kuptimi i drejtë i këtyrë përfitimeve si nga fermerët ashtu dhe nga aktorët e tjerë të zinixhirit të vlerës, e shoqëruar me mbështetjen teknike dhe financiare përmes projekteve të ndryshme do të ndihmojë në rritjen e sipërfaqeve të mbjella me BMA në parkun kombëtar Korab – Koritnik.

2. Përmbledhje ekzekutive

Bimët aromatike dhe mjekësore gjejnë një përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, farmaceutike dhe kozmetike. Ka një kërkesë të lartë për lëndë të parë, veçanërisht nga vendet e BE-se dhe Shtetet e Bashkuara. Për të plotësuar këtë kërkesë të tregjeve për lëndë të parë, në Shqipëri dhe në zonat kryesore prodhuese të BMA-ve është krijuar një zinxhir i vlerës që nis nga vjelësit, grumbulluesit e vegjël, përpunuesit dhe eksportuesit. Sipas të dhënave të fundit të Eurostat, Shqipëria ka eksportuar në 2022, rreth 12,060 ton bimë aromatike dhe mjekësore, të cilat kanë gjeneruar një të ardhur prej 41,5 milionë Euro.

Në zonën e Dibrës mbledhen rreth 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike në këtë zonë, nga të cilat 16 prej tyre janë të klasifikuara në një nga statuset e rrezikimit. Vjelja e pakontrolluar rrezikon zhdukjen e disa llojeve, gjë që do të shkaktonte dëme të pakthyeshme në biodiversitetin e florës së kësaj zone.

Në këtë prizëm, lind nevoja e gjetjes së mundësive të tjera të sigurimit të lëndës së parë. Kultivimi i BMA-ve vlerësohet si një zgjidhje e qëndrueshme dhe afatgjatë për problemin e shfrytëzimit të pakontrolluar të florës spontane.

Kultivimi i bimëve aromatike dhe mjekësore (BAM) vlerësohet si një aktivitet që gjeneron të ardhura të qëndrueshme ekonomike dhe krijon vende të reja pune. Kjo është kuptuar më së miri nga shumë fermerë në Shqipëri, veçanërisht në qarqet e Shkodrës, Korçës dhe Elbasanit, të cilët janë të përfshirë në këtë sektor. Në këtë kontekst, qeveria shqiptare ka hartuar politika mbështetëse për nxitjen e kultivimit të BAM-ve. Një tregues i qartë i këtyre politikave është dhe përfshirja në programin IPARD III e subvencionimit të mbjelljeve të bimëve aromatike dhe mjekësore dhe gjithashtu mbështetja për hapësirat dhe pajisjet e procesimit të këtyre bimëve..

Qarku i Dibrës megjithëse ka kushte agro-ekologjike shumë të favorshme për kultivimin e shumë bimëve mjekësore, aktualisht zë një vend modest në kultivimin e BAM-ve. Sipas INSTAT janë vetëm 6 ha të kultivuara me BAM në këtë qark në vitin 2021. Bimët kryesore që kultivohen aktualisht në këtë qark janë ciani dhe tërfili i kuq. Ndërkohë, qarku i Dibrës është një nga

furnizuesit më të mëdhenj më lëndë të parë, BAM të thara për kompanitë e eksportit në Shqipëri. Ky është një tregues i qartë se sektori i BAM-ë në qarkun e Dibrës është i bazuar gjerësisht në vjeljen e bimëve spontane dhe akoma nuk po shfrytëzon mundësitë dhe asetet që posedon ky rajon për kultivimet e tyre.

Ky potencial të madh për kultivimin e BAM në Dibër, deri më sot, nuk është vlerësuar si duhet nga fermerët dhe nuk i është kushtuar vëmendje nga aktorët tjerë të zinxhirit të vlerës. Duke marrë parasysh strukturën e fermës në qarkun e Dibrës, e cila është fragmentuar, përzgjedhja e bimëve të cilat mund të kultivohet duhet bërë me kujdes, duke u përshtatur me këtë realitet. Bazuar në sa më sipër, me interes të veçantë për kultivim janë: bimë të cilat përdoren për lulet e tyre dhe bimë të cilat përdoren si herb. Këto kultura janë të përshtatshme me strukturën e fermës në këtë qark dhe njëkohësisht kanë të ardhura të larta për njësi të sipërfaqes. Bimë që kultivohen për pjesën e lules janë ciani, kalendula, mëllaga, agulicja, etj.). Gjithashtu edhe kultivimi i rigonit për herb dhe gjethe vlerësohet të ketë interes të lartë ekonomik. Duhet të theksojmë se bimët e mësipërme, në vendet e zhvilluara kultivohen shumë pak për shkak të kostos së lartë të punës me dorë e cila është e domosdoshme me këto kultura. Kërkesa për këto BAM është shumë e lartë nga vendet e EU si: Gjermania, Austria, Franca, etj., dhe furnitorët kryesorë të këtyre tregjeve janë vende më pak të zhvilluara si Egjipti, Bullgaria, Shqipëria, etj.

Për këtë, është e nevojshme që të ngrihen disa modele fermash të kultivimit të BMA-ve, që do të shërbejnë si histori suksesi për t'i promovuar në një numër më të madh fermerësh të zonës. Ky studim analizon në detaje përfimet ekonomike, shoqërore dhe mjedisore që sjell përfshirja e një fermeri në kultivimin e BMA-ve.

Fermerët e vegjël në zonën e Dibrës përballen me probleme ekonomike dhe sektori i bujqësisë po bëhet jo tërheqës për ta. Duke qenë se ata zotërojnë sipërfaqe shumë të vogla toke (midis 0,5 – 1 ha), një fermë nuk mund të prodhojë të ardhura të qëndrueshme për të mbajtur familjen. Kultivimi i kulturave tradicionale si misri, gruri, patatet, perimet, pemët frutore etj., mund të japin një fitim neto maksimal prej 1000 – 1500 Euro për ha në vit. Duke qenë se këto të ardhura janë shumë të ulëta, fermerët përpiqen të punojnë në sektorë tjerë si ndërtimi, shërbimet, transporti etj.

Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike është një aktivitet që gjeneron të ardhura shumë më të larta krahasuar me kulturat tradicionale, veçanërisht nëse BMA-të prodhohen nën regjimin e prodhimit organik, çmimet janë më të larta. Në analizat financiare të kryera në këtë studim, një familje mund të gjenerojë të ardhura neto prej 4,000 – 9,000 Euro për ha në vit. Këto të ardhura mund të jenë shumë tërheqëse për një familje fermere që të merret seriozisht me kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike organike.

Në këtë prizëm, përfshirja e fermerëve të zonës së Dibrës në kultivimin e BMA-ve lidhet drejtpërdrejt me krijimin e vendeve të qëndrueshme të punës. Duke marrë parasysh madhësinë mesatare të tokës në pronësi të familjeve, 1 ha tokë e mbjellë me BMA do të sigurojë punë të qëndrueshme për dy persona. Fermat që do të kuptojnë përfitimet ekonomik nga aktiviteti i kultivimit të BMA-ve do të synojnë të zgjerohen duke marrë me qera toka në zonën e tyre. Kjo do të shtonte numrin e të punësuarve në familje dhe do të tërhiqte dhe të rinjtë për t'u përfshirë në këtë aktivitet.

Vlen të theksohet se komunitetet me të ardhura të ulëta kanë probleme sociale. Një problem thelbësor në Shqipëri, veçanërisht në zonat rurale është pabarazia gjinore. Gjithashtu, të rinjtë nuk shohin të ardhme të mirë në fshatrat ku jetojnë, ndaj migrojnë në qytete të mëdha ose emigrojnë në vende të tjera të zhvilluara.

Nxitja e kultivimit të BMA-ve do të ketë një ndikim pozitiv social në zonën rurale të parkut të mbrojtur dhe rreth tij, duke përmirësuar jetën sociale dhe komunitare. Më shumë të ardhura për fermerët janë të lidhura ngushtë me një jetë më të mirë sociale, edukim më të mirë për fëmijët e tyre, përmirësimin e barazisë gjinore dhe zbutjen e migrimit dhe emigrimit të të rinjve. Kjo lidhet edhe me reduktimin e braktisjes së kësaj zonë rurale.

3. Arsyet pse është e nevojshme ndërhyrja

Në Zonën e Mbrojtur Korab – Koritnik janë të evidentuara rreth 511 lloje të ndryshme bimësh fanerogame, nga të cilat, 316 specie nga 52 familje janë të klasifikuara si bimë mjekësore dhe aromatike. Bimët mjekësore dhe aromatike përfaqësojnë rreth 61.8% të florës së zonës së mbrojtur Korab Koritnik. 57 bimë të larta janë të përfshira në Listën e Kuqe të IUCN-së, klasifikuar si në rrezik zhdukjeje në shkallë të ndryshme: 4 bimë në status “kritik” (CR), 10 bimë në statusin “në rrezik” (EN), 14 bimë në statusin “vulnerabël” (VU), 2 bimë në statusin “pranë rrezikimit” dhe 27 bimë në statusin “në rrezikim më të ulët”. Aktualisht, në zonën e Dibrës mbledhen dhe eksportohen 63 lloje bimësh mjekësore dhe aromatike në këtë zonë, nga të cilat 16 prej tyre janë të klasifikuara në një nga statuset e rrezikimit. Mbledhja e pakontrolluar nga vjelësit e zonës rrezikon që të dëmtojë biodiversitetin e florës së kësaj zone dhe konkretisht popullatat natyrore të bimëve aromatike dhe mjekësore.

Vlen të theksohet gjithashtu se, në zonën e mbrojtur Korab – Koritnik popullsia jeton me të ardhura të ulëta dhe janë të rrezikuara nga papunësia. Kjo ka ndikuar që një pjesë e popullsisë të migrojë drejt qyteteve ose të emigrojë jashtë vendit. Është për t’u shqetësuar fakti se emigrimi i banorëve të zonës, vecanërisht e të rinjve është në një trend rritës.

Duke marrë për bazë këto dy probleme të mëdha, dëmtimi i biodiversitetit të zonës së mbrojtur Korab – Koritnik dhe papunësia e lartë, lind nevoja për të ndërhyrë me projekte afatgjata që kanë për qëllim të nxisin sektorin e prodhimit të bimëve aromatike dhe mjekësore. Angazhimi i fermerëve në këtë sektor vlerësohet si një mundësi shumë e mirë e diversifikimit të fermave të të vogla dhe që mund gjejë zbatim në këtë zonë e cila ofron kushte të përshtatme agro – klimaterike për kultivimin e BMA-ve.

4. Objektivat e projektit dhe shtrirja në kohë e tij

Objektivi i përgjithshëm është përgatitja e planit të biznesit për kultivimin dhe grumbullimin e BAM-ve nga komunitetet brenda dhe rreth KKPA-së.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është “të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale dhe palëve të interesuara për vlerat, ekosistemet dhe burimet e Parkut Kombëtar Korab Koritnik dhe zonave rreth saj”.

Ndërhyrja që do të bëhet nga World Vision Albania do të jetë në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi. Kjo ndërhyrje do të konsistojë në ndërthurjen e aktiviteteve të mëposhme:

- a) Trajnimi i banorëve të zonës lidhur me shfrytëzimin e qëndrueshëm të florës spontane
- b) Trajnimi i fermerëve lidhur me teknologjitë e kultivimit dhe të pas vjeljes së bimëve aromatike dhe mjekësore të përzgjedhura.
- c) Mbështetja e disa fermave pilot për kultivimin e BMA-ve që do të shërbejnë si modele suksesi për t’u promovuar në fermerët e tjerë.
- d) Nxitja e krijimit të 2 – 3 grupeve që do të investojnë në pajisje dhe facilitete të thjeshta të tharjes së BMA-ve, ku do të bëhet dhe grumbullimi, tharja, paketimi dhe ruajtja e përkohshme e BMA-ve të vjela.
- e) Mbështetja e grupeve të fermerëve në lidhjen e kontratave afatgjata me eksportues të BMA-ve, që do të jenë të bazuara në parimet e tregtisë së ndershme – *fair trade*.
- f) Mbështetje e grupeve të fermerëve për zbatimin e standartit organik dhe certifikimi i tyre sipas standartit organik të BE-së dhe/ose të standartit organik USDA në varësi të kërkesës

Propozohet që projekti të zbatohet në një periudhë kohorë dy-vjeçare me mundësi shtrirjeje në kohë. Në vitin e parë do të zhvillohen trajnimet e fermerëve lidhur me shfrytëzimin e qëndrueshëm të florës spontane, teknologjitë e kultivimit dhe teknologjinë e pasvjeljes së BMA-ve. Gjithashtu, do të identifikohen 5 fermerë, që do të mbështeten me asistencë teknike dhe subvencionim të kostove të prodhimit për të filluar mbjelljet e para të BMA-ve. Këto do të

shërbejnë si ferma pilot për të nxitur modelin e fermave të kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore. Ndërkohë, me angazhimin e fermerëve të parë në kultivimin e BMA-ve do të fillojë dhe puna për ngritjen e sistemeve organike të kultivimit dhe lidhjen e mundësive të kontratatave me eksportues. Krijimi i grupeve të fermerëve dhe investimet në pajisje dhe facilitete të tharjes së BMA-ve do të jetë një ndërhyrje që do të kryhet në vitin e dytë. Kjo për faktin se kërkohet pak kohë që modeli i fermave të kultivimit të BMA-ve të zgjerohet në një numër të më shumë fermerësh, të cilët duhet të ndërgjegjësohen për të kryer investime të përbashkëta.

5.Kulturat/bimët e identifikuara

FSRD pasi ka kryer një vlerësim të kushteve agro – klimaterike të kësaj zone paralelisht me një studim të tregut, ka identifikuar 5 bimë aromatike dhe mjekësore me interes të veçantë për kultivimin e tyre: rigoni, ciani, mëllaga, kalendula dhe agulicja. Eksportuesit e intervistuar pohojnë se ndjejnë vështirësi për të plotësuar sasinë e kërkuar nga klientët e tyre për lulet e këtyre BMA-ve.

Ndërkohë, për BMA-të që kultivohen për herb, eksportuesit dhe ekspertët e fushës këshillojnë kultivimin e rigonit në zonën e Dibrës.

Pra, bazuar në këto vlerësime dhe në kërkesën e lartë, 5 bimët e përzgjedhura për kultivim në zonën e Dibrës do të jenë: rigoni, ciani, mëllaga, kalendula dhe agulicja.

Vlen të theksohet se të pesta këto bimë gjenden në florën spontane të zonës së Dibrës, një tregues që mbështet idenë se kultivimi i këtyre BMA-vë në zonën e Dibrës është plotësisht i mundur, ndërkohë që garanton cilësi dhe rendiment të lartë.

Disa eksportues shqiptarë janë duke ndërmarrë iniciativë të modelit të kontraktimit të fermës. Ata lidhin marrëveshje bashkëpunimi me fermerë, duke u dhënë fara dhe fidanëve të BMA-ve, me kushtin që këta të shesin pranë eksportuesve produktet e tyre. Këto janë marrëveshje me interes të dyanshëm. Fermerët marrin falas ose kundrejt një çmimi të ulët materialin mbjellës bimor, ndërkohë që eksportuesit sigurojnë lëndën e parë për eksport për të cilën kanë nevojë.

Eksportuesit pohojnë se kanë kërkesë të lartë për BMA të çertifikuara si organike. Kështu që cdo fermer i zonës së Dibrës, i cili do të angazhohej në kultivimin e BMA-ve duhet të synojë të aplikojë praktikat e kultivimit organik dhe të çertifikohet sipas këtij standarti.

Në përzgjedhjen e 5 BMA-ve me interes për kultivim në zonën e Dibrës është marrë në konsideratë dhe cikli i shkurtër i hyrjes në prodhim. Ciani, aguliçja, mëllaga dhe kalendula janë bimë një vjeçare me cikël të shkurtër që hyjnë shpjet në prodhim. Në këtë mënyrë, fermeri do të arkëtojë të ardhura në një kohë të shkurtër 3 – 7 muaj nga mbjellja, në varësi dhe të kohës së mbjelljes (në pranverë ose në vjeshtë).

5.1 Karakteristikat për çdo kulturë

Rigoni

Rigoni apo Çaj Mali njihet me emrin shkencor *Origanum vulgare* L. Rrigoni e ka origjinën nga fjalët greke oros = mal dhe gonos = zbukurim, d.m.th. bimë që zbukurojnë malet.

Gjinia *Origanum* bën pjesë në familjen Lamiaceae (Labiatae), që karakterizohet nga një diversitet i gjerë morfologjik dhe kimik. Rrigoni (*Origanum vulgare*) bimë shumëvjeçare tufore me shumë kërcëj që dalin nga rizoma nëntokësore e saj me kërcëj me qëndrim vertikal dhe të degëzuar që rriten 20–90 cm, të pasur me qime gjëndërore. Lulëzon nga mesi i muajit Qershor e deri në Gusht-Shtator.

Praktikat bujqësore për *Origanum vulgare*

Rrigoni është një prej bimëve mjekësore dhe aromatike, për të cilat ka pasur interesim të madh në vitet e fundit. Rrigoni (*O. vulgare*) është një bimë shumëvjeçare me origjinë nga Azia, Europa dhe Afrika Veriore e cila është shumë tolerante ndaj temperaturave dhe thatësirës.

Gjatë peridhës së dimrit, pjesa mbitokësore shkatërrohet krejt, por rrënjët ruajnë vitalitetin për tu rivegjetuar në periudhën e pranverës. Mundësia e kultivimit të *Origanum vulgare* në rajonin e Dibrës është potencialisht e mundur. Prodhimi dhe përmbajtja e vajrve esenciale janë ekzaminuar gjatë stinëve të ndryshme dhe fazave të rritjes së bimëve. Kushte agroklimaterike të përshtatshme për rrigonin raportohen në intervalin 5–28°C me një sasi të reshjeve vjetore në

intervalin 400-2700 mm , dhe rritet shume mire ne toka me PH alkaline 4.5–8.7. Rrigoni është bimë e ditëve të gjata. Normalisht fotoperioda influencon ne rritjen e bimëve dhe diferencimet e luleve. Bimët rriten në kushtet normale në intervalin 12-16 orë dritë në 24 orë futen në stadin e diferencimit të plotë rreth 60 deri 90 ditë pas kultivimit.

Kultivimi mund të realizohet në toka të thata, të dranzhuara shumë mirë dhe ne disa raste edhe në toka alkaline. Bazuar në cilësitë e tokës, për kultivimin e rrigonit është e nevojshme edhe pleherimi me fosfat amoniumi dhe kontroll të dëmtuesve. Megjithatë si pjesa më e madhe e bimëve aromatike, edhe rrigoni nuk ka dëmtime serioze nga sëmundjet apo insekt dëmtuese. Kjo mendohet që lidhet me aftësinë inhibitore të vajrave eseciale që përmbajnë bimët aromatike mjekësore. Në përgjithësi korrja bëhet gjatë fazës së lulëzimit. Korrja realizohet në korrjen e bimëve në nje gjatësi jo më të vogël se 10 cm nga toka. Pas korrjes bimëzat e reja apo filiziat do të rritne për të realizuar prodhimin për të korrat e ardhëshme.

Ciani

Centaurea cyanus, i njohur zakonisht si ciani apo kokoceli në shqip, është një bimë një vjeçare e familjes Asteraceae (shqip: Kompozite), e cila rritet në Shqipëri dhe Evropë. Ciani, ka lule si yll-si me ngjyrë të zakonshme blu të shkëlqyeshme (sepse ka dhe me lule ngjyra të tjera, si të bardhe, rozë, kuqe, etj).

Bima e cianit është një bimë barishtore me degëzime, që rritet në lartësi nga 40 deri 90 cm, me degëza të gjelbra në gri. Gjethet i ka të drejta me majucë. Gjethet e poshtme shpesh janë me të çara në formë fideri nga poshtë pjesërisht me fije. Gjethet janë heshtore, të gjata 1- 4 cm. Kaptina përmban shumë lule të vogla, të dendura, të rrethuara me lule zakonisht shterpë, të cilat kanë formë petalesh dhe kështu e tërë kaptina në aspektin e polenizimit vepron si një lule e vetme.

Praktikat bujqësore për Cianin

Mbjellja e cianit realizohet në pranverë në të gjithë vendin, por në zonat malore preferohet të mbillet në vjeshtë sepse bimët ruhen mirë gjatë dimrit dhe vegjetacioni në pranverë është më i shpejtë dhe më i madh duke bërë të mundur dhe lulëzimin e hershëm në fund të pranverës deri në sezonin vijues.

E vetmja përkujdesje shumë e rëndësishme është të mos ketë bimë ose rrënjë të tjera, sepse ciani nuk është bimë e fortë në mbijetesë ose konkurrim me bimë të tjera. Do ishte mirë të vendosnim shkopinj mbajtës të arritshëm me lidhëse dhe në distanca të ngushta me cian që bimët të mos shtypen ose mos përthyhen nga era apo shiu, kjo ndihmon edhe procesin e korrjes si dhe rrit nivelin e higjenës.

Ciani rritet mirë në vende me ndriçim diellor të plotë dhe njëkohësisht në hije të pjesshme. Ciani rritet mirë në tokë mesatare pa plehërim shtesë ose plehërim bazë.

Megjithatë për një prodhim të kënaqshëm, toka duhet të jetë pjellore dhe e kulluar mirë. Testet e tokës janë të domosdoshme para aplikimit të kultivimit. Edhe nëse ekziston një informacioni mbi tokat në zonë, gjithmonë është e domosdoshme të realizohen testet e duhura për të përcaktuar pH, nivelet e lëndës organike dhe lëndëve ushqyese. Një tokë neutral, me pH prej 6.0-6.5 është i përshtatshëm për një zhvillim të mirë të cianit.

Edhe pse mund të rritet në toka me përmbajtje të varfër të lëndëve ushqyese, për qëllime kultivimi kërkohen toka me nivele mesatare dhe të larta lëndësh ushqyese. Gjithashtu duhen përzgjedhur toka që ngrohen lehtë dhe janë të shkrifëta. Tokat duhet të kenë ajrim dhe kullim të mirë, me një shkallë të mjaftueshme lagështie, por jo tejet të lartë e të ndodhura në lugje, pasi rritet infeksioni nga hiri. Në zgjedhjen e tokës duhet verifikuar mundësia e ujitjes në mbjellje dhe gjatë sezonit të verës. Është pak e ndjeshme ndaj të ftohtit.

Në rastet e mbjelljes me farë, Toka duhet të përgatitet në mënyrë të tillë që në momentin e mbjelljes të jetë e shkriftuar imët, gjë kjo që garanton mbulimin normal të farës dhe mbirej më uniforme.

Afati më i mirë i mbjelljes është 20 shtator - 30 tetor duke përdorur 4-5 kg farë për ha. Mbjellja bëhet me rreshta me distancë 20-30 cm dhe brenda rreshtit fara hidhet zinxhir. Kjo mënyrë mbjellje mund të realizohet me makinat e mbjelljes së grurit (lloj makinash të tërhequra nga pendë) të përshtatshme për terrenet e thyera. Mjaft mirë realizohet mbjellja edhe me shpërndarje të farës me dorë. Në këtë rast fara përzihet me rërë (për lehtësi shpërndarje uniforme) në raport 1:10 (1 kg farë, 10 kg rërë) dhe hidhet në tokë me thellësi 0.5-1 cm, pastaj

bëhet ngjeshja me dërrasë. Në të gjitha rastet, në tokat e pjerrëta bëhen vijat e mbledhjes së ujrave për të eliminuar gërryerjen e tokës. Gjithashtu farat e cianit mund të mbillen drejtpërdrejtë në fushë herët në pranverë, në fund të shkurtit ose në fillim të marsit. g

Bima e Cianin toleron temperaturat e ulëta nga 0°C deri -20°C, dhe është më pak e ndjeshme ndaj ngricave, por gjatë pranverave të ftohta këshillohet që mbjellja të vonohet deri në gjysmën e marsit. Norma mesatare e farës gjatë mbjelljes luhet në intervalin 2.5- 5 kg/ha (në varësi të makinës mbjellëse dhe distancave të rreshtave). Nëse për mbjellje përdoret një makinë mbjellëse pneumatike, kjo normë mund të përgjysmohet. Farat kërkojnë lagështinë e duhur për të mbirë. Fuqia mbirëse e farave të mira luhet nga 60-80% ndërsa sasia e bimëve që dalin mbi sipërfaqe shkon nga 40-60%.

Mëllaga

Mëllaga (*Malva sylvestris*) është një lloj bime jashtëzakonisht e përhapur dhe gjendet në të gjitha kontinentet. Rritet dhe zhvillohet thuajse kudo në vendin tonë, duke filluar nga bregdeti e deri në 1300 metra lartësi.

Emërtimi në gjuhën popullore: Mëllagë pyjesh, mëllagë. Përshkrimi: Është bimë barishtore një ose shumëvjeçare, që rritet 30-50 cm e lartë dhe shkon deri në 1.5 m, gjelbër në majë dhe i drunjëzuar në pjesën e poshtme. Nxjerr shumë kërcinj cilindrikë të degëzuar. Gjethet kanë madhësi të ndryshme në bazë më të mëdha, e duke shkuar drejt majës madhësia e tyre zvogëlohet. Gjethet i ka të këmbëra, të rrumbullakëta dhe të dhëmbëzuara me bisht deri 3 cm.

Praktikat bujqësore për Mëllagën

Meqenëse është e përhapur kudo, mund të themi se mëllaga nuk ka kërkesa të theksuara për tokë. Mëllaga e kultivuar rritet mirë në toka të ekspozuara nga dielli e të ngrohta, të mbrojtura nga era dhe të ajrosura mirë. Nuk ka kërkesa të veçanta por më shumë i përshtaten tokat e lehta me strukturë të mirë, më pjellori dhe regjim të mirë ujrash dhe ajror. Mund të kultivohet edhe në zona kodrinore malore. Bima i përshtatet thuajse të gjitha tokave si atyre të papunuara, në gërmadha, në vende të braktisura, nëpër rrugë etj. I përshtatet, rritet dhe zhvillohet në të gjitha klimat dhe mikroklimat e vendit tonë. Në kushtet tona bimët dimërojnë mirë por dimrat e ashpër

shkaktojnë dëmtime. Në pranverë fillon të zhvillohet shumë herët sepse gjethet i rezistojnë ngricave të hershme pranverore.

Mëllaga nuk është shumë kërkuese për sa i përket parabimës, por mirë është të mos ketë një parabimë malvace, siç është mëllaga e bardhë. E duron mirë edhe monokulturën. Po kështu mund të jetë parabime për të tjera kultura aromatike mjekësore. Në të njëjtën sipërfaqe mund të kultivohet 3-4 vjet, kurse si parakulturë i përshtaten kulturat prashitëse. Kujtojmë se kultivimi i këtyre llojeve bujqësore duhet të jetë organik ndryshe ngastra e humbet statusin organik. Sugjerohet që në çdo 5 - 6 vjet të parashikohet të paktën një vit, gjatë të cilit ngastra të përdoret si livadh artificial, me qëllim të rikthimit të pjellorisë së tokës dhe zhdukjes së barojave.

Përpara mbjelljes, toka duhet të përgatitet me kujdes dhe një sistemim i mire për të shmangur pellgje ujore. Punimi themelor në vjeshtë me Plug me paraplor, siguron kthimin dhe copëtimin e shtresës së tokës, por, njëkohësisht me këtë, prerjen e pjesëve nëntokësore të bimëve, dhe mbulimin e plehrave dhe mbeturinave të pasvjeljes. Ndërsa në pranverë aplikohet punim sipërfaqësor pak para mbjelljes së fidanëve ose trapiantimit të fidanëve. Varësisht nga tipi i tokës dhe faktorë të tjerë, punimi i thellë ndiqet nga punime të tjera sipërfaqësore pak para mbjelljes së farës ose trapiantimit të fidanëve si: diskimi, frezimi dhe kultivimi, me qëllim shkriftimin, kthimin e pjesshëm, përzierjen e tokës, prerjen e barërave të këqija dhe përgatitjen e nevojshme të shtretërve apo vllajave nëse do të përgatiten fidanë. Rekomandohet përdorimi i plehut të stallës i përgatitur mirë në dozën 50-60 t/ha.

Vjelja fillon nga qershori deri vonë në vjeshtë. Zgjatja e vjeljes varet nga kushtet klimatike dhe lagështia e tokës gjatë verës. Përveç luleve nga korriku fillon edhe vjelja e gjetheve.

Mëllaga kultivohet për të marrë prej saj lule dhe gjethe. Mullaga e mbjellë herët në pranverë krijon masë të gjelbërt të pasur me lule. Në vitin e parë, lulëzimi fillon në fillim të Korrikut dhe vazhdon deri në Shtator, ndërsa në vitin e dytë në Qershor. Lulet këputen me dorë bashkë me kupën e lules. Vjelja bëhet me intervale 2-3 ditore, në ditë me diell, pa lagështirë e vesë. Praktikë e përhapur, edhe për prodhimin e luleve, është trajtimi si bimë njëvjeçare duke e rimbjellë çdo

vit, me prodhimtari të kënaqshme. Vjelja duhet të jetë e shpejtë me qëllim të ruhet ngjyra natyrore e bukur.

Vjelja e luleve nuk mund të mekanizohet; prandaj kërkon një fuqi punëtore të lartë në periudha të njëpasnjëshme duke qenë se lulëzimi i mëllagës është i shkallëzuar. Normalisht duhen 20-25 punetore per 1 ha të mbjellë me mëllage. Lulet qëndrojnë të hapura për një ditë dhe më pas petlat palosen.

Duke qenë se vjelja e luleve duhet të bëhet me dorë, është e volitshme që të synohet në prodhimin e cimave dhe gjetheve, rendimentet e të cilave luhaten në afro 30 -40- 60 kg/100 m² material i thatë që arrihet në 2 -4 vjelje vjetore, sipas ecurisë sezonale dhe mundësive për ujitje. Rendimenti i luleve të thata mund të arrijë 0,7 – 1 t/ha.

Përveç luleve nga Korriku fillon edhe vjelja e gjetheve. Megjithatë, në pjesën më të madhe të rasteve, produkti është përbërë nga gjethet dhe lastarët që vilen kur bima ka arritur një lartësi 20-30 cm dhe lastarët nuk janë drunjëzuar ende. Kur kultura e mëllagës është e destinuar për prodhimin e gjetheve, bëhen dy vjelje (kositje) gjatë verës në periudhën maksimale vegetative, duke nisur që nga viti i parë. Vjelja mund të kryhet me kositej të posacme ose kose, duke praktikuar një prerje të pakten 10-15 cm lartsi mbi tokë. Rendimenti i gjetheve të fresketa harkun kohor të vitit luhatet nga 10 deri 15 t/ha ose 2- 3 t/ha i thatë. Gjethet që janë eventualisht të verdha ose të prekura nga ndryshku duhet të eliminohen (largohen nga parcela).

Kalendula

Kalendula është një bimë me origjinë nga rajoni i Mesdheut, por mund të kultivohet gjerësisht në Evropë, shpesh si bimë dekorative. Kalendula është bimë me përshtatshmëri klimatike të mirë dhe kjo i ka mundësuar të kultivohet për tregtim në një areal të gjerë, që përfshin si zona të ftohta (Gjermani, Hungari, Çeki, Rusi, Poloni, Austri, Zvicër) ashtu edhe të nxehta (Egjipt, Marok, Turqi).

Pavarësisht tolerancës klimatike, kalendula rritet mirë në vende me ndriçim diellor të plotë dhe shkon mirë në zona disi të thata. Ajo mund të kultivohet në zona ku temperatura mesatare e qershorit, korrikut e gushtit është ndërmjet 17°C dhe 20°C në parcela të hapura dhe me diell. Mund të kultivohet edhe në zona kodrinore, deri në 800 m mbi lartësinë e detit, në zona me një

ekspozim të mirë. Optimali i vegjetacionit është nga 20 - 30°C. Temperaturat optimale për mbirjen e farërave janë 8 - 10°C.

Calendula officinalis L. ishte me origjinë nga rajoni i Mesdheut, por mund të kultivohet gjerësisht në Evropë, shpesh si bimë dekorative.

Praktikat bujqësore për Kalendulën

Kalendula rritet mirë në vende me ndriçim diellor të plotë dhe preferon zona disi të thata. Ajo mund të kultivohet në zona ku temperatura mesatare e qershorit, korrikut, dhe gushtit është ndërmjet 17 dhe 20°C dhe parcela është e hapur dhe me diell. Temperaturat optimale për mbirjen e farërave janë 8 -10°C.

Edhe pse mund të rritet në toka me përmbajtje të varfër të lëndëve ushqyese, për qëllime kultivimi kërkohen toka me nivele mesatare dhe të larta lëndësh ushqyese. Gjithashtu duhen përzgjedhur toka që ngrohen lehtë dhe janë të shkrifëta. Tokat duhet të kenë ajrim dhe kullim të mirë, me një shkallë të mjaftueshme lagështie, por jo tejet e lartë e të ndodhura në lugje, pasi rritet infeksioni nga hiri. Në zgjedhjen e tokës duhet verifikuar mundësia e ujitjes. Është pak e ndjeshme ndaj të ftohtit.

Nuk rekomandohet ri mbjellja e kalendulës në vitin pasardhës por të paktën pas 3-4 viteve. Zgjedhja e drejtë e parabimës varet kryesisht nga veçoritë e tyre biologjike, në një shkallë të madhe nga përkatësia e llojit, nga periudha kur liron tokën (për të pasur kohë të mjaftueshme për kryerjen e masave të nevojshme agroteknike), në qoftë se është kulturë prashitëse ose kulturë me sipërfaqe mbuluese kultivimi.

Në përgjithësi, parabimë më të mira janë drithërat, bishtajoret për kokërr, perimet e ndryshme, zhardhokoret dhe bimët foragjere të cilat lirojnë tokën shpejt dhe japin mundësi për përgatitjen në kohë të tokës dhe për mbjellje në afat të farës ose fidanit.

Krahas karakteristikave të lules, kritere përzgjedhje të varietetit për prodhimin organik janë edhe rezistenca ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Agulice

Primula veris Eshtë bimë shumëvjeçare me gjethe vezake ose vezake gjatore me një bisht me flatra të gjera. Lulet janë në ngjyrë të verdhë ose në ngjyrë ari të vendosura në lulesa të përkulura. Kupa është në formë kambane me diametër 8 - 20 mm, ndërsa kurora ka diametër 8 – 30 mm. Rritet spontanisht në pyje, livadhe dhe deri në kullotat subalpine. Rritet pothuaj kudo, nuk ka shumë kërkesa për token apo klimën.

Praktikat bujqësore për agulicen

Fillimisht fara sigurohet nga bimësia spontane pasi luleve tu ketë filluar rrënia e petaleve (në fazën e fillimit të tharjes së luleve). Në këtë kohë vilen me kujdes lulet, thahen mirë që të shkoqen lehtësisht. Materiali bimor i shkoqur nuk mund të ndahet nga fura për këtë arsye për mbjellie hidhet i gjithë materiali i lules së shkoqur. Meqenëse fara është e imët, duhet të mbillet në toka të shkriptuara mirë. Mbillet në periudhën shtator- tetor duke përdorur rreth 6 kg farë për ha.

Gjatë mbjelljes fara përzihet me rërë në raport 1:10 (1 kg farë: 10 kg rërë) dhe hidhet në tokë në një thellësi prej rreth 2 cm, pastaj ngjishet me dërrasë përsipër. Fara shpërndahet uniformisht me dorë. Si shërbim pas mbjelljes kryhet pastrimi i barishteve që konkurrojnë bimësinë e mbjellë, ndonjë plehërim organik dhe prashitje për largimin e barërave të qeëjia dhe ajrimin e tokës.

Vjelja e prodhimit: Fillon kur lulet kanë hyrë në fazën e lulëzimit të plotë nga mesi i prillit dhe në maj.. Vjelja bëhet manualisht në kohë të kthjellët. Pas tharjes prodhimi vendoset në thasë të pastër dhe bëhet gati për dorëzim dhe shitje. Prodhimi i përgatitur duhet të ketë keto karakteristika cilësore:

5.2 Zonat e identifikuara

BMA-të e cituara më sipër mund të kultivohen shumë mirë në tokat bujqësore të qarkut Dibrës. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje se në cilat Njësi Administrative mund të kultivohen BMA-të e përzgjedhura.

Nj. Administrative	Rigoni	Ciani	Mëllaga	Kalendula	Aguliçja
Maqëllarë	x	x	x	X	x
Muhurr	x	x	x	X	x
Melan	x	x	x	X	x
Kastriot	x	x	x	X	x
Sllovë			x	X	x

Përgjithësisht këto 5 BMA mund të kultivohen shumë mirë në pesë Njësitë Administrative të Parkut Kombëtar Korab – Koritnik: Maqëllarë, Muhurr, Melan, Kastriot dhe Sllovë.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësitë fiziko – kimike të bimëve aromatike dhe mjekësore janë klima dhe kushtet agro – ekologjike të tokës.

Për sa i përket klimës, duhet të merret parasysh kohëzgjatja e ditës, sasia e reshjeve dhe amplituda e temperaturave. Këta faktorë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në proceset fiziologjike dhe biokimike të bimëve, veçanërisht ato që përfshijnë reaksionet enzimike, që ndikojnë në zhvillimin e bimëve dhe biosintezën e lëndës organike.

Kushtet klimatarike të kësaj zone janë të favorshme për kultivimin e BMA-ve. Ato janë të njëjta ose të ngjashme me kushtet klimatarike të rritjes së bimëve në habitatet e tyre natyrale. Fakti se disa nga bimët e përzgjedhura në këtë studim si: rigoni, mëllaga dhe aguliçja gjenden në habitate natyrale të florës spontane të kësaj zone është një tregues se kushtet klimatarike të këtyre zonave të Dibrës janë të favorshme për kultivimin e tyre. Ndërkohë, ciani dhe kalendula, më së shumti janë bimë që kultivohen dhe që gjejnë kushte të përshtatshme klimatarike në zonën e Dibrës.

Fermerët duhet të tregojnë kujdes në përzgjedhjen e vendeve për kultivimin e këtyre BMA-ve. Bimët që kultivohen kërkojnë vende me diell, të ajrosura mirë, të mbrojtura nga erërat e forta dhe të sigurta nga ngricat e dimrit.

Toka duhet të jetë pjellore dhe të përmbajë sasi të nevojshme të makroelementëve (N,P,K), mikroelementëve, dhe lëndës organike për një zhvillim optimal të bimëve. Çdo bimë aromatike dhe mjekësore ka kërkesa specifike për lëndët ushqyese. Këshillohet që para kultivimit, të kryhet një analizë e tokës për të kuptuar përmbajtjen e lëndës ushqyese dhe pjellorinë e saj. Nëse arrihet

në përfundimin se toka ka përmbajtje të ulët të elementëve ushqyes të caktuar, atëherë kryhet plehërimi i tokës. Vlen të theksohet gjithashtu se shumica e bimëve aromatike dhe mjekësore kërkojnë një pH neutral të tokës (midis 6,5 – 7.5).

Qarkullimi bujqësor është shumë i rëndësishëm. Këshillohet që të bëhet qarkullimi i BMA-ve me kultura të tjera pasi kjo ndikon në pjellorinë, bilancin uhor dhe organik të tokës, mbron bimët nga sëmundje dhe dëmtues të ndryshëm, si dhe nga barërat e këqija. Kulturat bujqësore më të përshtatshme për qarkullimin bujqësor janë bishtajoret (bizelja, fasulja, thjerrëza, batha, jonxha, etj). Një bimë aromatike dhe mjekësore duhet të mbillet në të njëjtët toke 1 – 3 vite. Pas vitit të tretë, prodhimi bie dhe bimët janë më të ekspozuara ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve.

Për kultivimin e bimëve që do të certifikohen sipas standartit organik, është e rëndësishme që të përzgjidhen toka ku nuk qënë të mbjella kulturë intensive ku janë kryer trajtime me produkte për mbrojtjen e bimëve. Duhet të shmangen tokat ku më parë është kultivuar patatja ose perimet, si dhe toka që ndodhen pranë pemtoreve me mollë, dardhe, qershi dhe fruta të tjera. Janë shumë të përshtatshme tokat djerrë, ose tokat e mbjella më parë me drithëra dhe jonxhë.

6. Modeli i propozuar për kultivim (do zhvillohet për cdo kulturë me vete - so sherbeje dhe si material trajnimi)

6.1 Modeli i fermes

